



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

---

**ADGJA.nr.07/2023**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, Kryetari i Gjykatës Valon Totaj, duke vendosur përkitazi me ankesën disiplinore të parashtruar nga R.Zh nga Gjakova, ndaj gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit, R.K., H.H. dhe M.N., lidhur me vendosjen në lëndën AA.nr.937/2022, të Gjykatës së Apelit në Kosovë, në kuptim të nenit 9, paragrafi 1.1 dhe 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, me datën 13.06.2023, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa disiplinore e parashtruar nga R.Zh nga Gjakova, ndaj gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit, R.K., H.H. dhe M.N., lidhur me vendosjen në lëndën AA.nr.937/2022, të Gjykatës së Apelit në Kosovë.

**A r s y e t i m**

Me datën 02.06.2023, përmes emailit zyrtar të Gjykatës së Apelit, është pranuar ankesa e ankuesit R.Zh nga Gjakova. Parashtruesi në ankesë ka pretenduar se kolegji i gjykatës së apelit në përbërje prej gjyqtarëve R.K. – kryetar kolegji si dhe H.H. e M.N. – anëtar, kanë përdorur standarde të dyfishta dhe në kundërshtim të plotë me ligjin nr.03/L-199. Tutje ka theksuar se kolegji i lartcekur nuk ka respektuar te drejtën e parashtruesit të kërkesës për "qasje ne gjykate", dhe rrjedhimisht, në rastin konkret ka shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6.1 të KEDNJ. Ka konsideruar se ankesa e tij e parashtruar në Gjykatën e Apelit është e bazuar sepse i njëjti pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative ka kërkuar që të lirohet në pagesa e taksës gjyqësore në shumë prej 50 euro, pasi që ishte i papunë, për çka edhe ka dorëzuar dokumente të cilat vërtetojnë se i njëjti është i papunë. Tutje ankuesi ka kërkuar të rishikohet ky rast skandaloz dhe të pa precedent dhe ankesën e paditësit të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktvendimi i ankimuar i kolegjit të përbërë nga gjyqtarët e lartcekur dhe lënda t’i kthehet shkallës së parë për rigjykim në merita të padisë. Po ashtu nga kryetari i gjykatës ka kërkuar që pas hetimit dhe konstatimit së bashku me Njësinë e Hetimit të KGJK, dhe jo vetëm të merren masa për shkelje

disiplinore por edhe sipas detyrës zyrtare konform ligjit ta drejtoni tek organi akuzues për hetim të shkeljeve të cilat paraqesin vepra penale të konsumuara nga të apostrofuarit gjyqtarë të Gjykatës së Apelit të Kosovës, më detalisht sikurse në ankesën e tij.

Kryetari i Gjykatës, pas pranimit dhe vlerësimit të ankesës, me datë 05.06.2023, nga kolegji gjykues i Gjykatës së Apelit në lëndën AA.nr.937/2022, në përbërje prej gjyqtarit R.K. – gjyqtar referues, H.H. dhe M.N. - anëtarë, ka kërkuar deklarim lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesi R.Zh.

Gjyqtari R.K., ka dhënë deklaratë me datën 06.06.2023, ku ka theksuar se ka qenë gjyqtar referues kur është shqyrtuar dhe votuar lënda e paditësit AA.nr.937/2022, pas shqyrtimit dhe trajtimit të çështjes në procedurë, kolegji kompetent ka marrë vendim unanimisht për refuzimin e ankesës ashtu siç figuron në aktvendimin përkatës të Gjykatës së Apelit. Tutje ka theksuar se qëndrimet e kolegjit janë të shprehura në aktvendimin përkatës në të cilat janë dhënë vlerësimet procedurale, konstatimet faktike si dhe baza ligjore e vendimmarrjes. Gjithashtu ka theksuar se me as një veprim qoftë si gjyqtar referues apo edhe si kolegji në përgjithësi, nuk kanë vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit për Konfliktet Administrative që rregullojnë çështjet e konfliktit administrativ, dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dispozitave të Udhëzimit Administrativ nr.01/2019, për Unifikimin e Taksave Gjyqësore dhe as në kundërshtim me rregullat e Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar dhe drejtë e plotësisht janë zbatuar dispozitat ligjore në rastin e vendimmarrjes sipas ankesës, më detalisht sikurse në deklaratën e tij.

Gjyqtari H.H., ka dhënë deklaratë me datën 07.06.2023, ku ka theksuar se ka qenë anëtar i kolegjit kur është shqyrtuar dhe votuar ankesa e ankuesit e parashtruar kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pas referimit nga gjyqtari referues dhe trajtimit të ankesës, pretendimeve ankimore dhe shkresave të lëndës është marrë aktvendimi me të cilin është refuzuar ankesa e ankuesit si e pabazuar dhe aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar, me arsyetim se ankuesi nuk i ka plotësuar kërkesat nga Ligji për Procedurën Konktestimore nga neni 253.4 dhe Udhëzimi Administrativ për Unifikim të Taksave Gjyqësore, konkretisht neni 8, për tu liruar nga pagesa e taksës gjyqësore. Tutje ka theksuar se ankuesi nuk është autoritet për të vlerësuar se aktvendimi i marrë nga kolegji ka shkelje kushtetuese sepse këtë e bënë Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës dhe atë pas kërkesës së këtui parashtruesit të ankesës. Po ashtu ka theksuar se ankuesi mund t'i përdorë mjetet e jashtëzakonshme juridike me të cilat mund të konteston aktvendimin në Gjykatën Supreme pastaj edhe në Gjykatën Kushtetuese, të cilat do të konstatojnë eventualisht se paditësit i është shkelur ndonjë e drejtë që ia njeh ligji në këtë rast, më detalisht sikurse në deklaratën e tij.

Gjyqtari M.N., ka dhënë deklaratë me datën 08.06.2023, ku ka theksuar se me aktvendimin AA.nr.937/2022, të datës 10.05.2023, është refuzuar ankesa e paditësit si e pabazuar ndërsa aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar. Tutje ka theksuar se ankuesi në këtë rast

nuk ka parashtruar ndonjë provë konkrete me të cilin do të vërtetohej përgjegjësia eventuale disiplinore e gjyqtarit, andaj në rastin konkret nuk është bërë ndonjë shkelje disiplinore ashtu siç është përcaktuar në Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, më detalisht sikurse në deklaratën e tij.

Kryetari i Gjykatës së Apelit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, vlerësimit të pretendimeve ankimore dhe deklaratës së gjyqtarëve R.K., H.H. dhe M.N., ka gjetur se:

- ankesa e ankuesit R.Zh, është **e pabazuar**.

Kryetari i Gjykatës, pas shqyrtimit të ankesës së parashtruar nga ankuesi si dhe deklaratave të gjyqtarëve, vlerësoi se pretendimet ankimore sa i përket mënyrës së vendosjes, janë pretendime të pabazuara dhe të paqëndrueshme, për faktin se gjyqtarët janë të pavarur në vendimmarrje, pavarësi kjo e cila i'u është garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Po ashtu gjyqtarët janë të pavarur në punë e tyre, vendosin sipas ligjit dhe vendimet merren në bazë të provave që shqyrtohen dhe verifikohen në shqyrtim kryesor. Sipas vlerësimit të kryetarit, pavarësia individuale, është pavarësia e gjyqtarëve në kryerjen e funksionit të tyre gjyqësor, që nënkupton se gjyqtarët duhet të jenë meritore, objektiv, neutral dhe të liruar nga çdo ndjenjë e ndikimit kur ushtrojnë funksionin e tyre gjyqësor.

Lidhur me pavarësinë në vendimmarrje nuk duhet të ketë asnjë ndërhyrje të pavend apo të pajustificuar në procesin gjyqësor dhe nuk duhet që vendimet gjyqësore të gjykatave t'i nënshtrohen ndryshimit. Në rastin konkret Kryetari i Gjykatës nuk ka kompetencë që të ndryshojë vendimet gjyqësore të nxjerra nga gjyqtari apo kolegji i gjyqtarëve dhe se pala e pakënaqur ndaj aktgjykimit të Gjykatës së Apelit nëse vlerëson se vendimi është marrë në kundërshtim me dispozitat kushtetuese, i njëjti eventualisht mund të parashtrorë kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, ndërsa nëse vlerëson se ka baza të tjera ankimore, atëherë i njëjti eventualisht mund t'i drejtohet Gjykatës Supreme.

Kryetari i Gjykatës vlerësoi, se në rrethanat aktuale të çështjes nuk ka bazë për të hapur një hetim disiplinor lidhur me vendosjen e çështjes së parashtruesit të ankesës, meqë me prova të shqyrtuara nuk është vërtetuar se gjyqtarët kanë bërë shkelje të Kodit të Etikës. Ndërkaq, për punën profesionale të gjyqtarit apo kolegjit, kompetent për vlerësim profesional është Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve i cili vepron në kuadër të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës, ku i njëjti bën vlerësimin e performancës për gjyqtarët.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit në kuptim të nenit 9, paragrafi 1, pika 1.1. të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**ADGJA.nr.07/2023, me datë 13.06.2023**

**Kryetari i Gjykatës**  
**Valon Totaj**

***Vendimi t'i dorëzohet:***

- Parashtruesit të ankesës,
- Gjyqtarëve R.K., H.H. dhe M.N.,
- Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe
- Një kopje në shkresa të lëndës,